



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1452/11 prot.

Datë 11.07.2024

V E N D I M
Nr. 860/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.07.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. **732/2024**, datë 21.06.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave” me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*QuantX IT Solutions*” SHPK me NIPT M31904013D dhe adresë Rruga e Dibrës, Njësia Administrative nr. 8, kati i parë, zona kadastrale nr. 8370. 1001 nr. Pasurie 10/2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

“IdentiTek” SH.A me adresë Rruga “Xhanfize Keko”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1 Në datë 21.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **732/2024**, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave”, me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE, sipas vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Me shkresën nr. 420/19 prot., datë 04.07.2024, protokolluar me tonën nr. 1452/8 prot., datë 08.07.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr **732/2024** datë 21.06.2024 për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar" me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt “Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave” me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.

II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 420/19 prot., datë 04.07.2024, protokolluar me tonën nr. 1452/8 prot., datë 08.07.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr **732/2024** datë 21.06.2024 për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar" me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt "Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave" me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.

II.2 Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe konstatoi se autoriteti kontraktor Identitek Sh.A ka rishikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "*QuantX IT Solutions*" SHPK në zbatim të vendimit Nr. **732/2024**, date 21.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3 Sa me sipër, autoriteti kontraktor Identitek Sh.A, ka zbatuar vendimin Nr **732/2024**, date 21.06.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur, e thjeshtuar" me Nr. REF-04829-05-14-2024, me objekt "Furnizim vendosje pajisje për infrastrukturën teknike të zyrave" me fond limit 4,017,031.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

